

GISday



Aktivite në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të GIS

ASIG në bashkëpunim me Departamentin e Gjeografisë pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, organizuan Forumin “Dita Ndërkombëtare e GIS”, me datë 20 nëntor 2024.

Ky forum, bëri bashkë profesionistë dhe ekspertë të sektorit të gjeoinformacionit nga institucionet publike e private, bota akademike dhe biznesi të cilët ndanë eksperiencën e tyre në projekte dhe aplikime të ndryshme të GIS, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe inovacionin në teknologjitë gjeohapësinore.

Gjithashtu, në datë 19 nëntor 2024, u organizuan disa aktivitete të cilat i paraprinë Forumit të Ditës Ndërkombëtare të GIS. Konkretisht, u realizua leksioni i hapur me studentë nga Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, me temë: “Monitorimi i territorit me teknologjinë Remote Sensing” dhe një seancë interaktive me nxënësit e Shkollës së Mesme Profesionale “Karl Gega”, në të cilin u demonstruan funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar dhe të dhënat gjeohapësinore të publikuara në këtë Gjeoportali.




Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin dhe publikimin në Gjeoportalin Kombëtar të aksit rrugor nacional "Përmet - Çarçovë - Leskovik - Korçë - Fushë Studë". Gjatësia e aksit të mbuluar me fotografi 360° është 372 km.



Fotografimi me teknologjinë UAV



Ortofoto, Izoipse, DSM Petrelë

ASIG ka filluar tashmë t'ju vijë në ndihmë institucioneve gjithashtu dhe me fotografime ajrore me dron, duke ju vënë në dispozicion të dhëna gjeohapësinore të saktësisë së lartë brenda një afati të shkurtër kohor, si më poshtë:

- Ortofoto (Rezolucion 3 cm)
- DSM(Digital Surface Model)
- DTM(Digital Terrain Model)
- Izoipse (Shpeshtësia çdo 1 m).

Publikime në Gjeoportalin Kombëtar


Zona Arkeologjike dhe Qendra Historike

ASIG në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar Vendimet e Këshillit të Ministrave për:

- Zonën Arkeologjike 'A' dhe 'B' të qytetit të Elbasanit;
- Qendrën Historike të qytetit të Elbasanit dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj.

Informacioni gjeohapësinor për këto shtresa është publikuar në përputhje të plotë me përcaktimet e miratura me Vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 643, dhe nr. 644, datë 16.10.2024.

Për më tepër informacion mbi këto shtresa [klikoni këtu](#).



Zonat e Mbrojtura Natyrore



ASIG në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor të përditësuar të shtresës "Zonat e mbrojtura natyrore", për temën "Zonat e mbrojtura".

Për më tepër informacion mbi këtë shtresë [klikoni këtu](#).

Zgjerimi i Hartës Bazë - Qyteti i Gramshit

ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Imazhi i hartës bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të qytetit të Gramshit. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 5.2 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.



PJESËMARRJE NË AKTIVITETE

ASIG merr pjesë në konferencën “Platforma Rajonale e Evropës dhe Azisë Qendrore për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë”

Përfaqësues të ASIG morën pjesë në konferencën “Platforma Rajonale e Evropës dhe Azisë Qendrore për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë” në kuadër të zbatimit të projektit që Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) po zhvillon me JICA, në Budva, Mal i Zi, në datat 06-08 Nëntor. Në këtë konferencë midis të tjerave u prezantua edhe projekti i ASIG për “Monitorimin e Territorit me Teknologji të Avancuar”. Implementimi me sukses i këtij projekti ka mundësuar krijimin e hartave digjitale si dhe grafikëve statistikorë të zonave të prekura nga zjarri, të përfuara nga përpunimi i imazheve satelitore, në mbështetje të AKMC-së në vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e riskut dhe dëmeve nga zjarret.



ASIG merr pjesë në konferencën “Avancimi në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale”



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në konferencën “Avancimi në Digjitalizimin e Shërbimeve Kadastrale” e cila u organizua nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, më 20 dhe 21 Nëntor, në Prizren, Kosovë.

Kjo konferencë shërbeu si një platformë unike për shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe zgjidhjeve inovative, duke u udhëhequr drejt një sistemi kadastral digjital e konkurrues, jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë e më gjerë.

Gjatë dy ditëve të kësaj konference u zhvilluan sesione të ndryshme me prezantime e diskutime mes ekspertësh e profesionistësh të ndryshëm të fushës së kadastrës dhe gjeoinformacionit për avancimet më të fundit në fushën e kadastrës, idetë dhe praktikat më të mira nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, ngritjen e bashkëpunimit dhe lidhjeve profesionale etj..

TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të nismës së ndërmarrë nga ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve teknike të Institucioneve Publike dhe Njësive të Qeverisjes

Vendore, ekspertë të ASIG realizuan gjatë muajit nëntor 2024, trajnime për gjeoinformacionin me institucionet e mëposhtme:

- Bashkia Përmet në 07.11.2024
- Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore (AMVV) në 14.11.2024



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Hapësira e BE-së si Mbështetje për Rregulloren e Produkteve pa Shpyllëzim

Rregullorja e Produkteve pa Shpyllëzim synon të ndalojë hyrjen në tregun e BE-së të produkteve që vijnë nga toka e shpyllëzuar kohët e fundit ose që kanë kontribuar në degradimin e pyjeve. Për të arritur këtë, BE-ja përdor teknologji nga Hapësira e BE-së, duke përfshirë të dhënat e monitorimit satelitor Copernicus dhe sistemin e pozicionimit Galileo, të cilat mundësojnë analiza të sakta për origjinën e produkteve përmes koordinatave GNSS dhe inspektimeve me bazë në të dhënat e Vëzhgimit të Tokës. Një projekt pilot ka treguar sesi kompanitë mund të përdorin këto teknologji për të identifikuar dhe parandaluar shpyllëzimin, duke ndihmuar BE-në të luftojë ndryshimet klimatike dhe të promovojë produkte të qëndrueshme në treg.

Mjeti për Pemët dhe Hapësirat e Gjelbra Identifikon Zonat Prioritare për Gjelbërim

Kompania Bluesky International, ka prezantuar një mjet të ri brenda Hartës Kombëtare të Pemëve (National Tree Map - NTM) që ndihmon urbanistët dhe këshilluesit mjedisorë të vlerësojnë zonat urbane bazuar në rregullin 3+30+300 për gjelbërimin e qyteteve, prezantuar në vitin 2021 nga Cecil Konijnendijk. Rregulli kërkon praninë e tre pemëve, mbulim me kurorë prej 30% dhe hapësira të gjelbra brenda 300 metrave nga çdo ndërtesë banimi ose pune për përmirësimin e mirëqenies. Mjeti i ri është testuar me sukses nga Këshilli i Aberdeenshire dhe tashmë është i disponueshëm për klientët e NTM-së për të identifikuar zonat prioritare për gjelbërim.

AKTIVITETE NË VIJIM

BIOSPACE25 - Biodiversity Insight From Space

Agjencia Evropiane e Hapësirës (ESA) së bashku me partnerët e saj organizon në Fraskati të Italisë, konferencën dedikuar aplikimit të Satelitit Remote Sensing (SRS) në dimensione të ndryshme të biodiversitetit, dhe adresimin e përdorimit të Vëzhgimeve të Tokës në të gjitha sferat, nga ekosistemet tokësore, të ujërave të ëmbla, bregdetare e deri te ato detare.

10 - 14 Shkurt 2024

www.asig.gov.al

Commercial UAV Expo Europe

Ekspozita Komerciale e UAV-ve të Evropës, aktiviteti kryesor për dronët komerciale, do të zhvillohet nga 8-10 prill 2025 në Amsterdam. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të zbulojnë strategji dhe zgjidhje të zbatueshme, të njohin përparimet më të fundit në teknologjinë ajrore dhe të krijojnë kontakte me profesionistë të industrisë.

8 - 10 Prill 2025

Telefon: +355 (0)42 223 762;

Geospatial World Forum (GWF)

Forumi Botëror i Gjeoinformacionit (GWF) do të zhvillojë edicionin e 16-të, në Madrid, Spanjë. Ky forum është një platformë bashkëpunuese dhe interaktive që pasqyron vizionin e përbashkët të komunitetit global gjeohapësinor duke mbledhur profesionistë, agjenci kombëtare të hartografisë, sektorin privat, si dhe përdorues të rëndësishëm nga qeveria dhe shërbimet për qytetarët.

22 - 25 Prill 2025

www.geoportal.asig.gov.al

E-mail: info@asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;